



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 20.05.2025

Njoftim për “Bashkëpunëtorë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr.98, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), nenit 7 dhe nenet 10-12 të Urdhrit të Ministrit nr.32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, rregullores së brendshme nr. 492 datë 30.07.2020, “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm” në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP, shpall kërkesën për bashkëpunëtorë të jashtëm që mund të angazhohen në realizimin e veprimtarive të planifikuara dhe miratuara në planin e punës së institucionit

Bashkëpunëtorët është e nevojshme të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë.
2. Të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në arsim.
3. Të kenë vlerësimin “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm” në provimin e kualifikimit të mësuesve.
4. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Zhvillimin profesional të stafëve mësimore (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve/drejtuesve, zhvillim i trajnimeve etj.);
 - Menaxhimin e veprimtarive apo projekteve në institucionin arsimor ku punon;
 - Drejtimin dhe menaxhimin e institucionit arsimor;
 - Bashkëpunime me ASCAP dhe institucione të tjera të varësisë së MAS për realizimin e veprimtarive të tyre mbështetje të e
5. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
6. Të kenë aftësi të thelluara kërkimore për vlerësimin e cilësisë së institucioneve arsimore parauniversitare;
7. Të njohin metodologjitë e vlerësimit të cilësisë së IAP-ve.
8. Të kenë aftësi të mira për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj.
9. Preferohen vlerësues nga Rrjeti Kombëtar i Vlerësuesve:
10. Preferohen me aftësi shumë të mira digjitale.

Etj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në, fotokopje të diplomës, dëshmi të ndryshme kualifikimi/trajnimesh dhe fotokopje të dokumentit të identitetit pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në adresën: Rruga ”Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë ose në email-in sekretaria@ascap.edu.al brenda datës 26.05.2025, ora 16.30.

Faleminderit!